



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 27.05.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR RIKONSTRUKSIONIN E STADIUMIT “RUZHDI BIZHUTA”, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për rikonstruksionin e Stadiumit “Ruzhdi Bizhuta”, Bashkia Elbasan.
2. Materiali i plotë grafik bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMEZI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



ZNJ. LINDITA NIKOLLA

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

